



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:000829

Datë: 03.02.2025

Numri i dokumentit: 06796156

P.nr.5/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi-Muçaj, në çështjen penale kundër të pandehurit H.F, për shkak të veprës penale “*Vjedhja e shërbimeve*” në bazë të nenit 314 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2277/2023, e datës 29.12.2023, duke vendosur lidhur me kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, në mbështetje të nenit 248 par.1 nën par.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPPRK*), të ushtruar nga mbrojtësi i të pandehurit, av.Burhan Shabanaj, nga Peja, me datën 03.02.2025, jashtë seancës, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për hudhjen e aktakuzës, e paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit H.F, av.Burhan Shabanaj, nga Peja, dhe sipas detyrës zyrtare:
- II. HUDHET AKTAKUZA** e Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshme, në shenjë PP/II.nr.2277/2023, e datës 29.12.2023, **SI E PALIGJSHME**.
- III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit **H.F**, i lindur me 10.08.1985, në, në Komunën e Pejës, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr..... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, lidhur me veprën penale “*Vjedhja e shërbimeve*” nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, për shkak aktakuza është ne kundërshtim më ligjin.
- IV.** Pala e dëmtuar KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- V.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 29.12.2023, ka ngritur aktakuzën nën shenjë PP/II.nr.2277/2023, kundër të pandehurit H.F, për veprën penale “Vjedhja e shërbimeve” në bazë të nenit 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, pas analizimit të aktakuzës lëndore si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se i pandehuri H.F, nuk është marrë në pyetje në procedurën paraprake ashtu siç e përcakton dispozita e nenit 149 par. 1 të KPP-së (NR. 08/L-032) që është në fuqi, shprehimisht është përcaktuar se *“Përveç rasteve të parapara në nenin 234, paragrafi 2 të këtij Kodi, i pandehuri duhet të merret në pyetje nga prokurori i shtetit para ngritjes së aktakuzës. Nëse i pandehuri hetohet për vepër apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është deri në tre (3) vjet burgim, mjafton që i dyshuari apo i pandehuri të jetë marrë në pyetje në polici me autorizim të prokurorit të shtetit”*.

Gjykata në kuptim të nenit 235 par.4 të KPPRK-së, gjykata sipas aktvendimit P.nr.5/24 të dt.26.02.2024, ka kërkuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, që të bëjë plotësimin e aktakuzës lëndore PP/II.nr.2277/2023, e datës 29.12.2023 ashtu që të plotësoj aktakuzën me deklaratën e marrjes në pyetje të pandehurit, dhe atë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, në mënyrë që pastaj të plotësohen kushtet ligjore për vazhdimin në statet tjera të procedurës penale.

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me dt.27.03.2024 e ka kthyer aktakuzën e plotësuar konkretisht ka dorëzuar procesverbalin e marrjes në pyetje të të pandehurit H.F, me dt.26.03.2024, pranë Stacionit Policor ne Pejë.

Shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale në kuptim të nenit 240 të KPPRK-së, është mbajtur me datë 12.08.2024, me ç’rast i akuzuari është deklaruar i pafajshëm dhe gjykata të njëjtin e ka informuar që në afat prej 30 ditësh ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

I pandehuri përmes mbrojtësit të pandehurit H.F, av.Burhan Shabanaj, me datë 15.11.2024, ka parashtruar kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të prokurorisë, dhe atë nën arsyetimin se: sepse ka baze të artikuleshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pa mbështetshme dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari H.F ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Thekson se për standardin e te provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm nuk jepet definicion i saktë në dispozitat e KPPK-së, por në përputhje me praktiken gjyqësorë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe teorinë juridike të pranuar me konsensus të gjere dhe të zbatuar në juridiksionet që kanë pranuar parimin e sundimit të ligjit përkufizohet si vërtetim i fakteve që janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm, gjegjësisht nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm se i pandehuri nuk e ka kryer një vepër të caktuar penale. Parakusht për ngritjen e aktakuzës, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 234 të KPPK-së është ekzistimi i dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet. Në përputhje me këtë dispozitë nëse nuk ekziston dyshimi i bazuar mirë se është

kryer vepra penale, atëherë gjykata duhet që ta hedh poshtë aktakuzën e prokurorisë. Sipas mbrojtjes është fakt që njehsori me shifrën formalisht është në emrin e të mbrojturit tim H. (G) F. nga K. Pejë, mirëpo ai nuk është shfrytëzues fakti i tij. Objekti afarist në të cilin është i vendosur njehsori shifrën është në pronësi të babait të mbrojturit tim i cili e ka emrin G. (I). F. nga fsh..... K. Pejë. G. (I). F. nga fsh..... K. Pejë, me datën 03.03.2021 në cilësinë e qiradhënësit, ka lidhur Kontratë mbi Qiranë me qiramarrësin "....." Sh.P.K me seli në Gjakovë, me numër unik identifikues me përfaqësues pronarin E. (A). J. me objekt qiraje, objektin afarist në sipërfaqe prej 1660m² dhe objektin tjetër në sipërfaqe prej 3480m², të dyja objektet ndërtuar në ngastrën me numër ZK K. Pejë. Fakti që H. (G.) F. nga fsh.. K. Pejë, nuk e ka në shfrytëzim njehsorin me shifrën, mirëpo në shfrytëzim e ka "....." SH.P.K me seli në Gjakovë me numër unik identifikues me përfaqësues pronarin E. (A.) J., vërtetohet edhe me Deklaratën Noterial LRP-nr.rend.nr..... të dhën para Noterit Arsim Avdijaj, nga E. (A.) J.. Andaj nga këto arsye ka propozuar që aktakuza të hudhet poshtë dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurit.

Një kopje të kërkesës për hedhje të aktakuzës gjykata i'a ka ekspeduar prokurorisë për t'u përgjigjur në kundërshtim të cilën e kanë pranuar me datën 09.09.2024, mirëpo nga ana e prokurorisë nuk është pranuar përgjigja në kërkesë për hedhje të aktakuzës të parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, sipas detyrës zyrtare gjeti se kërkesa për kundërshtimi ndaj provave të aktakuzë dhe kërkesa për hudhjen e aktakuzës janë të bazuara, pasi që ka gjetur se ekzistojnë rrethana të cilat e pengojnë ndjekjen penale dhe kjo për arsye sepse gjatë fazës hetimore, janë gjetur shkelje procedurale të cilat kanë cenuar ligjshmërinë e këtij procesi në tërësi.

I pandehuri H.F, sipas aktakuzës së prokurorisë PP.II.2277/23 të datës 29.12.2023, akuzohet për kryerjen e veprës penale *"Vjedhja e shërbimeve"* në bazë të nenit 314 paragrafi 1 të KPRK-së, e për të cilën vepër, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, ashtu që, nga shkresat e lëndës gjykata konstaton se prokurori i shtetit me datën 29.12.2023, ka ngritur aktakuzën kundër të pandehurit dhe se pas kërkesës së gjykatës të datës 26.02.2024 i ka sjellë gjykatës *"Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit"* i cili mban datën 26.03.2024, çka e bënë këtë provë të pa pranueshme për faktin se e njëjta është marrë pas ngritjes së aktakuzës, e cila aktakuzë është ngritë me dt. 29.12.2023 dhe si e tillë sipas gjykatës, e njëjta nuk është marr konform standardit të kërkuar me Kodin e Procedurës Penale, gjegjësisht nenit 151 par. 1, cili parasheh *"Para ngritjes së aktakuzës, i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake. Nëse i pandehuri hetohet për vepër apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se tre (3) vjet burgim, mjafton që të pandehurit t'i jepet mundësia që të përgjigjet me shkrim."*

Pra, procesverbali i sipër cekur, i dërguar nga prokuroria, është marr në kundërshtim të plotë me nenin 149 par.1, pasi që shihet qartë se i njëjti është përpiluar me datën 26.03.2024, ndërsa

aktakuza është ngritur me datën 29.12.2023, ashtu që marrja në pyetje e të pandehurit është bërë pas ngritjes së aktakuzës, duke pasur parasysh dispozitën e mësipërme, gjykata vlerëson mos marrja në pyetje dhe mosdhënia e mundësisë për tu deklaruar në lidhje me veprën penale për të cilën është ngarkuar është pengesë e pakapërcyeshme dhe pa mëdyshje shkelje e të drejtave të garantuara me këtë kod, e po ashtu në kundërshtim të plotë me nenin 9 të Kodi të Procedurës Penale, pra me parimin e barazisë së palëve në procedurë, pasi që të pandehurit nuk i është dhënë fare mundësia që të deklarohet lidhur me akuzën ndaj tij. Andaj, të gjitha këto veprime bazuar ne dispozitat ligjore te theksuara si me lartë është dashur që të ndermirën para ngritjes se aktakuzës, pavarësisht faktit se i pandehuri ka mundur që të mbrohet edhe në heshtje.

Për më tepër një veprim i tillë i prokurorisë është edhe në kundërshtim të plotë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në mënyrë decisive, në nenin 6 parasheh të drejtën për një proces të rregullt, e që sipas gjykatës, mos marrja në pyetje-mos dhënia e mundësisë për t'u deklaruar të pandehurit gjatë fazës hetimore (para ngritjes së aktakuzës) pa dyshim që cenon rregullsinë, pavarësinë dhe paanshmërinë e procesit në zhvillim.

Sipas vlerësimit të gjyqtarës së vetme gjykuese aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP/II.nr.2277/2023, e datës 29.12.2023, ndaj të pandehurit të H.F, për shkak të veprës penale “*Vjedhja e shërbimeve*” në bazë të nenit 314 paragrafi 1 të KPRK-së, nuk është ngritur konform dispozitave ligjore të nenit 235 par.1 të KPRK-së, që përfshin se çka duhet të përmbaj një aktakuzë.

Gjyqtarja e vetme gjykuese deklaratën e të pandehurit H.F, e dt.26.03.2024, të dhënë pranë Stacionit Policor në Pejë, e konsideron si provë të pa pranueshme konform dispozitës së nenit 243 par.1 nenpar.1.1 të KPRK-së, në të cilën parashihet që: “*provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar;*”

Në rastin konkret, nuk është kontestuese se sipas shkresave të lëndës ekziston një procesverbal me anë të të cilit vërtetohet se është marrë në pyetje i pandehuri H.F, në polici me autorizim të prokurorit të shtetit me dt.26.03.2024, mirëpo data se kur është marrë në pyetje dëshmon faktin se i pandehuri është marrë në pyetje pas ngritjes së aktakuzës çka e bën këtë procesverbal si provë të pa pranueshme.

Andaj, deklarata e të pandehurit H.F, e dhënë në polici me autorizim të prokurorit të shtetit me dt.26.03.2024, si provë e papranueshme ndahet nga shkresat dhe mbyllet dhe e njëjta mbahet e ndarë nga shkresat dhe provat tjera, konform dispozitës së nenit 243 par. 4 të KPRK-së ku parashihet që: “*Provat e papranueshme ndahen nga shkresat dhe mbyllet. Provat e tilla mbahen nga gjykata të ndara nga shkresat dhe provat tjera. Provat e papranueshme nuk mund të shqyrtohen apo të shfrytëzohen në procedurë penale, përveç në rastin e ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë.*”

Po ashtu, meqenëse sipas dispozitës së nenin 149 par.1, të KPRK-së, përcaktohet se: “*Përveç rasteve të parapara me nenin 234 paragrafi 2, të këtij Kodi, i pandehuri duhet të merret në pyetje*

nga prokurori i shtetit para ngritjes së aktakuzës. Nëse i pandehuri hetohet për vepër apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është deri në tre (3) vjet burgim, mjafton që i dyshuari ose i pandehuri të jetë marrë në pyetje në polici me autorizim të prokurorit të shtetit.”

Përfundimisht me dispozitën e nenit 234 par.2, të KPPRK-së, është parashikuar mundësia e ngritjes së aktakuzës edhe nëse i pandehuri nuk është marrë në pyetje në procedurë paraprake apo nuk ka dhënë deklaratë në procedurë paraprake, mirëpo një gjë e tillë është parashikuar se mund të ndodh, nëse i njëjti është në arrati ose për shkaqe tjera është i paarritshëm për organet e ndjekjes. Në situatat e tilla për të ardhur në shprehje një mundësi e tillë, duhet të jenë shterur të gjitha përpjekjet për ta gjetur të pandehurin nga nenet 172 (Thirrja), 173 (Urdhër arresti) 534 (Kërkimi i adresës së të pandehurit) dhe neni 535 (Dhënia e letër rreshtimit), me çka në rastin konkret në shkresa të lëndës nuk ka dëshmi që janë shterur përpjekjet siç është përcaktuar në nenin 234 par. 2 të KPPRK-së.

Meqenëse në këtë rast nuk kanë ekzistuar asnjëri nga kushtet e lartcekura, gjykata vlerëson se mos marrja në pyetje dhe mosdhënia e mundësisë për tu deklaruar në lidhje me veprën penale për të cilën është ngarkuar në procedurë paraprake, është shkelje e të drejtave të garantuara me këtë kod, e po ashtu në kundërshtim të plotë me nenin 9 të Kodi të Procedurës Penale, pra me parimin e barazisë së palëve në procedurë, pasi që të pandehurit nuk i është dhënë fare mundësia që të deklarohet lidhur me akuzën ndaj tij, çka rezulton se i është mohuar edhe e drejta e mbrojtjes.

Po ashtu, gjykata thekson faktin se, konform dispozitës së nenit 149 paragrafi 1 te Kodit Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, ka qenë e parashikuar se *"Para ngritjes së aktakuzës, i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake. Nëse i pandehuri hetohet për vepër apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se tre (3) vjet burgim, mjafton që të pandehurit t'i jepet mundësia që të përgjigjet me shkrim",* kurse në nenin 99 paragrafi 2 te këtij Kodi, ka qenë e parashikuar se *"Kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim tek prokurori i shtetit për dyshim të arsyeshëm për vepër penale ose vepra penale, për të cilat dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se tre (3) vjet burgim, dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngritë aktakuzë sipas nenit 235 të këtij Kodi.”*

Ndërsa, në rastin konkret, i pandehuri H.F, akuzohet për shkak të veprës penale *"Vjedhja e shërbimeve"* në bazë të nenit 314 para.1 të KPRK-së, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite. Bazuar në këto dispozita ligjore, rezulton se në rastin konkret, por edhe në rastet tjera, kur i pandehuri dyshohet me arsye për kryerjen e ndonjë vepre penale për të cilën është parashikuar dënim deri në tre (3) vjet burgim, mjafton që i dyshuari ose i pandehuri të jetë marrë në pyetje në polici me autorizim të prokurorit të shtetit, e që në rastin konkret një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Kodi i Procedurës Penale, i ka ndarë fazat e procedurës penale, të drejtat dhe detyrimet e secilës palë në procedurë, e në këtë drejtim siç u theksua më lart, detyrimin e prokurorit të shtetit për të zhvilluar hetime e ku pjesë e kësaj është edhe dëgjimi i të pandehurit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate është e domosdoshme dhënia e mundësisë të pandehurit që të paraqes mbrojtjen e tij, duke i dhënë në këtë formë mundësinë që të njihet me rezultatin e hetimeve, sfidimin dhe kundërshtimin e provave të mbledhura nga prokurori i shtetit, dhënien e mundësisë të pandehurit që eventualisht të propozoj marrjen e provave që shkojnë në favor të tij.

Mos ndërmarrja e këtij veprimi të detyrueshëm procedural, përkatësisht mos dëgjimi i të pandehurit para ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, e vë mbrojtjen në një pozicion të pabarabartë dhe në këtë formë, duke i pamundësuar të pandehurit që të njihet me rezultatin e hetimeve, përkatësisht veprimet hetimore të ndërmarra nga organi i akuzës, në esencë cenon dy prej parimeve kryesore procedurale penale e që janë parimi i kontradiktoritetit si dhe parimi i barazisë së armëve, ashtu që cenimi i këtyre parimeve, e vë në pikëpyetje të drejtën për një proces të rregullt, të paraparë me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, konventë kjo e zbatueshme drejtpërdrejtë në vendin tonë sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sipas praktikës së ndërtuar në shumë raste nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*tutje si: GJEDNJ*) rregullsia e një procesi gjyqësor në një rast procedural penal, nuk nënkupton vetëm procedurën e cila zhvillohet para gjykatës, por nënkupton të gjitha fazat e procedurës penale, ndër to edhe fazën e procedurës paraprake, andaj disa të drejta që burojnë nga neni 6 i KEDNJ-së, përkatësisht cenimi i këtyre të drejtave siç janë afati i arsyeshëm dhe të drejtat e mbrojtjes, mund të dëmtojnë rëndë procesin penal në tërësi.

Në frymën e dispozitave procedurale penale në vendin tonë, të cilat u theksuan më lart dhe praktikës gjyqësore të ndërtuar nga GJEDNJ, praktikë kjo e përfshirë edhe në vendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (shih për këtë Aktgjykimin me numër Pml.nr.343/2023 datë 22.07.2024), një ndër lehtësitë përkatësisht të drejtat që i gëzon një i pandehur në procedurën penale, është mundësia për tu njohur me rezultatet e hetimeve të zhvilluara gjatë gjithë procedurës, me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së tij. Në ndërlidhje më këtë edhe parimi i barazisë së armëve si një ndër elementet e procesit të rregullt gjyqësor, në vetvete parasheh që secilës palë duhet t'i ofrohet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në atë mënyrë që nuk e vendosin ata në një disavantazh në raport me palën tjetër. Në këtë kontekst, fakti që të pandehurit nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet për çështjen e/ndaj tij gjatë fazës hetimore, kur Prokurori i Shtetit po mblidhte prova për çështjen, e ka vënë mbrojtjen në një pozicion të pabarabartë dhe kjo, siç u theksua edhe më lart, ka cenuar rregullsinë apo ligjshmërinë e procesit penal, respektivisht të procedurës paraprake si pjesë e procedurës penale.

Po ashtu, prokurori i shtetit ka propozuar gjatë shqyrtimit gjyqësor verbalo-publik të bëhet shikimi dhe leximi i provave materiale si: Procesverbali i KEDS me nr. i datës 02.10.2021, Procesverbali i KEDS me nr. i datës 15.12.2021, Procesverbali i KEDS me nr. i datës 16.12.2021, Procesverbali i KEDS me nr. i datës 16.12.2021, Fatura e KES me nr.

i datës 28.12.2021, Foto-dokumentacioni i vendit të ngjarjes, mirëpo meqenëse aktakuza e lartcekur nuk është ngritur konform dispozitave ligjore atëherë gjykata nuk është marr fare me elaborimin e tyre, meqenëse aktakuza PP/II.nr.2277/2023, e datës 29.12.2023, është në kundërshtim më ligjin.

Vendimin mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko - civil gjykata e mori konform nenit 462 par. 3 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 par.1, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Andaj gjykata duke u bazuar në të lartcekurat më lart e konform nenit 248 par.1 pika.1.3, lidhur me 357 të KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.5/24, me datë 03.02.2025.

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.